

VENDIM
Nr.8, datë 21.5.1993

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë e përbërë nga:

Rustem Gjata,	Kryetar	i Gjykatës Kushtetuese
Feti Gjilani	Zv/kryetar	i Gjykatës Kushtetuese
Hilmi Dakli	Anëtar	i Gjykatës Kushtetuese
Veli Budo	Anëtar	i Gjykatës Kushtetuese
Franc Jakova	Anëtar	i Gjykatës Kushtetuese
Natasha Sheshi	Anëtare	e Gjykatës Kushtetuese
Thimjo Kondi	Anëtar	i Gjykatës Kushtetuese
Ylvi Myrtja	Anëtar	i Gjykatës Kushtetuese

asistuar nga sekretari Ylli Memudaj më datë 30.4.1993 dhe 21.5.1993, shqyrtoi në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.7 që i përket:

kërkuesIT: Grupi Parlamentar i Partisë Socialiste.

OBJEKTI

Shfuqizimin si antikushtetues të ligjit nr.7666, datë 26.1.1993 "Për krijimin e komisionit të rivlerësimit të lejeve për ushtrimin e avokatisë dhe për një ndryshim në ligjin nr.7541, datë 18.12.1991 "Për avokatinë në Republikën e Shqipërisë" sepse:

1) Ky ligj vjen në kundërshtim me nenin 16 të ligjit nr.7561, datë 29.4.1992 "Për disa ndryshime e plotësime në ligjin "Për dispozitat kryesore kushtetuese", i cili e konsideron avokatinë so profesion të lirë, që mund të ushtrohet nga çdo jurist që përmbush kushtet e caktuara.

2) Sipas nenit 15 të këtij ligji kushtetues, Këshilli i Lartë i Drejtësisë është i vetmi autoritet që vendos për emërimin, lëvizjen dhe përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve të shkallës së parë, të gjyqtarëve të apelit dhe të prokurorisë. Prandaj këtij organi nuk mund t'i jepen, me një ligj të zakonshëm, kompetenca për t'u hequr lejen e ushtrimit të profesionit edhe avokatëve, të cilët janë profesionistë të lirë.

3) Ligji i lartpërmendur nr.7666, datë 26 janar cenon rëndë parimin kushtetues të ndarjes së pushteteve, sepse e drejta për të ndaluar ushtrimin e profesionit apo të mjeshtërisë është lënë vetëm në kompetencën e gjykatës penale (nenet 17 e 24 të Kodit Penal).

GJYKATA KUSHTETUESE

pasi dëgjoi relacionin përkatës

VËREN:

Përmbajtja e neneve 1, 3 dhe 4 të Ligjit Nr.7666, datë 26.01.1993 "Mbi krijimin e komisionit për rivlerësimin e lejeve për ushtrimin e avokatisë...", është antikushtetuese për arsyet që vijojnë:

I. Neni 1 i ligjit të lartpërmendur përcakton se: "Në Ministrinë e Drejtësisë krijohet komisioni për rivlerësimin e lejeve për ushtrimin e avokatisë të lëshuara deri në kohën e hyrjes në fuqi të këtij ligji. Ministri i Drejtësisë kryeson komisionin. Ai propozon përbërjen e komisionit, i cili miratohet nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë".

Kjo dispozitë vjen në kundërshtim, para së gjithash, me nenin 16 të Ligjit Nr.7561, datë 29.04.1992 "Për disa ndryshime e plotësime në Ligjin Nr.7491, datë 29.04.1991 "Për dispozitat

kryesore kushtetuese", ku është sanksionuar tekstualisht se: "Avokatia ushtrohet si profesion i lirë. Veprimtaria e avokatisë rregullohet me ligj të veçantë". Këtë rezultim pa ndonjë mëdyshje se edhe në Republikën e Shqipërisë avokatia është tashmë një shoqatë profesionale e specializuar (urdhër apo rend i avokatëve) që, sipas ligjit ose statusit përkatës, administrohet drejtpërdrejt nga organet e zgjedhura të saj. Pra, asnjë ligj i zakonshëm ose organik nuk mund t'i shmanget parimit kushtetues (që është sanksionuar edhe në akte ndërkombëtare bashkëkohore), se avokatia është një profesion i lirë e rrjedhimisht i vetëadministrueshëm. Kjo natyrë juridike e avokatisë është shprehur edhe në nenet 3 e 4 të ligjit datë 18.12.1991 "Për avokatinë në Republikën e Shqipërisë".

Në nenin 3 është përcaktuar tekstualisht: "Për të mbikqyrur veprimtarinë e avokatisë krijohet Këshilli Mbikqyrës i përbërë prej kryetarit të degës së avokatisë në Ministrinë e Drejtësisë dhe prej gjashtë avokatëve të zgjedhur nga mbledhja e përgjithshme e avokatëve. Këshilli Mbikqyrës i avokatëve është i pavarur në ushtrimin e veprimtarisë së tij". Sipas nenit 4, Këshilli Mbikqyrës është i vetmi organ kompetent që: a) jep lejen për ushtrimin e profesionit të avokatit kur juristi plotëson kushtet e parashikuara në këtë ligj, b) vendos masat administrative dhe disiplinore për avokatët që shkelin rregullat e ushtrimit të profesionit të avokatit.

Edhe shqyrtimi i përmbajtjes së nenit 3 të Ligjit Nr.7541, datë 18.12.1991, nxjerr qartë në pah se gabimet e Këshillit Mbikqyrës të avokatisë në dhënien e lejeve për ushtrimin e këtij profesioni (kur ai nuk i korrigjon vetë) mund të ndreqen vetëm nga mbledhja e përgjithshme e avokatëve, që është organi më i lartë i tyre, dhe jo nga një komision "rivlerësimi", i cili sikurse rezultim nga nenet 1, 4 të Ligjit Nr.7666, datë 26.01.1993, ka karakter shtetëror.

II. Me nenin 3 të këtij ligji është shtuar në Ligjin "Për avokatinë në Republikën e Shqipërisë", edhe neni 12/a, i cili në mënyrë krejt imperative, përcakton se nuk lejohet të punojnë si avokatë ata juristë, që, gjatë cilësdo periudhë kohore të partisë-shtet, kanë kryer ndonjëherë nga detyrat e shumta të treguara në këtë dispozitë.

Formulimi i këtij neni shpreh qartë se lloji i detyrës që juristi ka kryer në organet e lartpërmendura të partisë-shtet është vënë si kriter i vetëm e përcaktues për të vendosur që atij t'i hiqet e drejta e ushtrimit të profesionit, pavarësisht nga fakti se ai jurist ka patur dhe ka cilësime morale e profesionale të duhura. Pra, mënjanimi i kriterit demokratik të vlerësimit individual të këtyre cilësive bie ndesh me nenin 28 të ligjit kushtetues Nr.7692, datë 31.03.1993, ku është sanksionuar se: "Secili ka të drejtë të fitojë mjetet e jetesës së tij me punë të ligjshme që e ka zgjedhur ose pranuar vetë. Ai është i lirë të zgjedhë profesionin dhe vendin e punës së tij...".

Në kundërshtim me këtë parim kushtetues, që është parashikuar edhe në nenin 6 të Paktit Ndërkombëtar për të drejtat ekonomike, sociale e kulturore (në të cilin Republika e Shqipërisë ka aderuar me Ligjin Nr.7511, datë 08.08.1991), nuk mund, sipas nenit 12/a të Ligjit datë 26.01.1993, të jetë avokat as juristi i ndershëm që ka kryer ndonjëherë nga detyrat e treguara në atë nen.

Madje në paragrafin e fundit të këtij neni (gërma "f") është përcaktuar se nuk mund të jenë avokatë: "Ata juristë që kanë përdorur dhunën fizike ose psikike gjatë hetimeve apo veprimeve të tjera, si edhe ata që kanë marrë pjesë në vrasjet në kufi". Përmbajtja e këtij paragrafi shpreh qartë se në secilën nga këto hipoteza të tij ndodhemi para kryerjes së krimeve të rënda. Mirëpo është nocion juridik i njohur se vetëm gjykata kompetente mund, me vendim përfundimtar të saj, të deklarojë fajtor personin të cilin e ka gjykuar për kryerjen e një krimi, dhe jo kurrë një komision për rivlerësimin e lejeve të avokatisë.

Pra, me këtë paragraf janë cënuar këto dy parime kushtetuese: a) i ndarjes së pushteteve (neni 3 i Ligjit Nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", b) i prezumimit të pafajësisë (neni 7 i Ligjit Kushtetues Nr.7692, datë 31.03.1993 ku thuhet se: "Askush nuk mund të quhet fajtor gjersa nuk i është provuar fajësia me vendim gjyqësor të formës së prerë"). Është e nevojshme edhe në nenin 14 të pjesës së tretë të Paktit Ndërkombëtar për të drejtat civile dhe politike, në të cilin Republika e Shqipërisë ka aderuar me Ligjin Nr.7510, datë 08.08.1991.

III. Në nenet 1 e 4 të Ligjit Nr.7666, datë 26.01.1993, është përcaktuar se Këshillit të Lartë i Drejtësisë i jepen edhe kompetencat ekskluzive që të miratojë përbërjen e komisionit

rivlerësues të lejeve për ushtrimin e avokatisë e të shqyrtojë ankimin kundër vendimit të këtij komisioni, që i ka parashtruar, brenda afatit ligjor avokati, të cilit i është hequr leja përkatëse.

Këto dy kompetenca, që i janë dhënë me këtë ligj të zakonshëm këtij organi të lartë të sistemit gjyqësor, janë antikushtetuese, sepse në nenin 15, paragrafi 2 të Ligjit Nr.7561, datë 29.04.1992 "Për disa ndryshime e plotësime në ligjin për dispozitat kryesore kushtetuese", është sanksionuar tekstualisht se: "Këshilli i Lartë i Drejtësisë, është i vetmi autoritet që vendos për emërimin, lëvizjen dhe përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve të shkallës së parë, të apelit si edhe të prokurorëve".

Pra, prerogativat e Këshillit të Lartë të Drejtësisë zbatohen vetëm për funksionarët e lartpërmendur të pushtetit gjyqësor (magjistratët) dhe nuk mund të shtrihen edhe ndaj avokatëve të cilëve, siç u nënvizua më lart, janë profesionistë të lirë dhe jo magjistratë.

IV. Nenet 1, 3 dhe 4 të Ligjit Nr.7666, datë 26.01.1993, janë antikushtetuese edhe sepse Konferenca mbi Sigurimin dhe Bashkëpunimin në Europë (KSBE), në mbledhjen e saj të zhvilluar në Kopenhagë, ka miratuar më 29.06.1990 "Dokumentin mbi dimensionin human", ku është përcaktuar, ndër të tjera, tekstualisht se: "Pavarësia e avokatëve do të njihet dhe mbrohet, sidomos përsa u përket kushteve të përfshirjes në këtë profesion dhe ushtrimit të veprimtarisë së tyre". (Neni 5, paragrafi 13, i këtij dokumenti)

Siç dihet, Republika e Shqipërisë është anëtare, me të drejta të plota e KSBE-së dhe në nenin 4 të Ligjit Nr.7491, datë 29.04.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", është sanksionuar se : "Republika e Shqipërisë njeh dhe garanton të drejtat dhe liritë themelore të njeriut...", të pranura në dokumentat ndërkombëtare".

Meqënëse nenet 1, 3 e 4 të Ligjit Nr.7666, datë 26.01.1993 "Për krijimin e komisionit për rivlerësimin e lejeve për ushtrimin e avokatisë ...", vijnë në kundërshtim me dispozitat e lartpërmendura të ligjeve kushtetuese të Republikës së Shqipërisë dhe si rrjedhojë duhet të shfuqizohen, nuk përlijet më ekzistenca e nenit 5 të atij ligji, që përcakton se: "Koha e ndalimit të ushtrimit të profesionit të avokatisë për personat që preken nga ky ligj është pesë vjet".

Përkundrazi, neni 2 i Ligjit Nr.7666, datë 26.01.1993, me të cilin është ndryshuar neni 12 i ligjit të tanishëm "Për avokatinë në Republikën e Shqipërisë", pajtohet me dispozitat e ligjeve tona kushtetuese në fuqi.

Pretendimi i parashtruar në këtë kërkesë të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste se vetëm gjykata penale mund të vendosë heqjen e së drejtës së ushtrimit të profesionit edhe ndaj avokatit, nuk është i bazuar. Sikurse thuhet shprehimisht në nenin 22 shkronja "b" të Ligjit të tanishëm "Për avokatinë në Republikën e Shqipërisë", ndaj avokatit ose asistentit, Këshilli Mbikqyrës, pasi vërteton shkeljet në kryerjen e detyrës, mund të marrë edhe masën e heqjes së të drejtës të ushtrimit të profesionit të avokatit deri në pesë vjet.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, duke bazuar në dispozitat e lartpërmendura të ligjeve kushtetuese në fuqi në zbatim të nenit 24, pika 2 e 10, dhe të nenit 26 të ligjit nr.7561, datë 29 prill 1992 "Për disa ndryshime dhe plotësime në ligjin "Për dispozitat kryesore kushtetuese".

VENDOSI:

"Shfuqizimin e neneve 1, 3, 4 e 5 të ligjit nr.7666, datë 26.1.1993 "Për krijimin e komisionit për rivlerësimin e lejeve për ushtrimin e avokatisë...", sepse vijnë në kundërshtim me dispozitat e sipërcituara të ligjeve kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, si edhe rrjedhimisht anulimin e vendimeve me të cilët ky komision u ka hequr avokatëve përkatës lejen për ushtrimin e këtij profesioni.

Ky vendim është përfundimtar dhe i formës së prerë.

Ai hyn në fuqi menjëherë pasi t'u jetë njoftuar zyrtarisht Kryesisë së Kuvendit Popullor, Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste dhe Ministrit të drejtësisë.